



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Seanca plenare e Kuvendit
P-069
Prishtinë, më 7, 8 dhe 11 korrik 2016

PROCESVERBAL

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 7, 8 DHE 11 KORRIK 2016**

Seancën e drejtoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, ndërsa i ndihmuan Sabri Hamiti dhe Slobodan Petroviq, nënkryetarë të Kuvendit.

Kryetari i hapi punimet e seancës plenare sipas rendit të ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Para se të procedojë me rendin e ditës, kryetari i njoftoi deputetët me vendimin e Presidentit të Republikës së Kosovës për zëvendësimin e deputetëve në Kuvendin e Republikës së Kosovës, si në vijim: Shukri Buja, kandidat i subjektit politik PDK-PD-LB-PSHDK-PKK, e zëvendëson ish-deputetin z. Enver Hoxhaj; Driton Çausi, kandidat i subjektit politik “Vetëvendosje”, e zëvendëson ish-deputetin z. Besnik Bislimi.

Kryetari i ftoi deputetët e rinj që ta japin betimin.

Kryetari e lexoi tekstin e betimit, kurse deputetët Shukri Buja dhe Driton Çausi e shqiptuan fjalën “betohem” dhe e nënshkruan deklaratën e betimit.

Kuvendi i zhvilloi punimet sipas pikave të rendit të ditës, si në vijim:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën këta deputetë: Faton Topalli, Vjosa Osmani, Nuredin Ibishi, Mexhide Mjaku-Topalli, Shpejtim Bulliqi, Visar Ymeri, Kadri Veseli dhe Rexhep Selimi, të cilat janë dhënë të plota në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti Faton Topalli i parashtroi pyetje kryeministrit të Kosovës, Isa Mustafa, lidhur me angazhimin e pjesëtarëve të “Mbrotjes Civile”.

Kryeministri i Kosovës, Isa Mustafa, nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputetja Donika Kadaj-Bujupi i parashtroi pyetje kryeministrit të Kosovës, Isa Mustafa, lidhur me veprimet e Qeverisë së Kosovës për ta parandaluar ndërtimin e “Luginës së Diellit” në Mitrovicën Veriore.

Kryeministri i Kosovës, Isa Mustafa, nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Ismajl Kurteshi i parashtroi pyetje kryeministrit të Kosovës, Isa Mustafa, lidhur me bazën ligjore për përfshirjen e 483 ish-pjesëtarëve të strukturave ilegale të Serbisë në sistemin e pagave nga janari i këtij viti, edhe pse ata nuk janë të punësuar?

Kryeministri i Kosovës, Isa Mustafa, këtë pyetje ia kishte bartur ministres Edita Tahiri, e cila iu përgjigj deputetit Ismajl Kurteshi.

Deputeti Salih Salihu i parashtroi pyetje kryeministrit të Kosovës, Isa Mustafa, lidhur me masat e Qeverisë së Kosovës ndaj kompanive private, të cilat vitin e kaluar kanë importuar grurë, i cili në dokumente të importit është shënuar si import i grurit të thyer, krunde, bizele e gërdhushta.

Kryeministri i Kosovës, Isa Mustafa, nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Bekim Haxhiu i parashtroi pyetje kryeministrit të Kosovës, Isa Mustafa, lidhur fillimin e ndërtimit të rrugës M2 nga mjetet e siguruaranëpërmjet marrëveshjeve të ratifikuara në Kuvend për huamarrje.

Ministri Lutfi Zharku iu përgjigj deputetit Bekim Haxhiu.

Deputetja Mexhide Mjaku-Topalli i parashtroi pyetje ministrit të Financave, Abdullah Hoti, lidhur me përdorimin e formulës për alokimin e mjeteve financiare për Drejtoritë e Shëndetësisë dhe Mirëqenie Sociale nëpër komuna.

Ministri Abdullah Hoti iu përgjigj deputetes Mexhide Mjaku.

Deputeti Mytaher Haskuka i parashtroi pyetje ministrit të Kulturës, Kujtim Shala, lidhur me zbatimin e Ligjit për trashëgiminë kulturore dhe Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit.

Ministri i Kulturës, Kujtim Shala, nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Danush Ademi i parashtroi pyetje ministrit të Infrastrukturës, Lutfi Zharku, lidhur me ndërtimin e një lidhjeje afër qytetit të Ferizajt për t’u lidhur në autostradën Prishtinë-Han i Elezit.

Ministri Lutfi Zharku iu përgjigj deputetit Danush Ademi.

Deputetja Ganimete Musliu i parashtroi pyetje ministrit të arsimit, z. Arsim Bajrami, lidhur me plotësimin e kushteve teknike për lëvizjen e personave me aftësi të kufizuara në të gjitha shkollat e Kosovës.

Ministri Arsim Bajrami iu përgjigj deputetes Ganimete Musliu.

Deputetja Besa Baftija i parashtroi pyetje ministrit të arsimit, z. Arsim Bajrami, lidhur meveprimet e MASHT për mosmbylljen e paraleleve të ndara të Gjimnazit në Zhegër.

Ministri Arsim Bajrami iu përgjigj deputetes Besa Baftija.

Deputetja Besa Baftija i parashtroi pyetje ministrit të arsimit, z. Arsim Bajrami, lidhur meveprimet e MASHT-it ndaj nëpunësve që kishin larguar nxënësit nga testi i maturës.

Ministri Arsim Bajrami iu përgjigj deputetes Besa Baftija.

Deputetja Albulena Haxhiu i parashtroi pyetje ministrit të Financave, Abdullah Hoti, lidhur me pretendimet për mosrespektimin e procedurave të brendshme dhe konflikt interesi nëpër disa organizata buxhetore.

Ministri Abdullah Hoti iu përgjigj deputetes Albulena Haxhiu.

Deputetja Albulena Haxhiu i parashtroi pyetje ministrit të Financave, Abdullah Hoti, lidhur me zbatimin e ligjit për auditimin e brendshëm në komunat me shumicë serbe.

Ministri Abdullah Hoti iu përgjigj deputetes Albulena Haxhiu.

Deputetja Donika Kadaj-Bujupi i parashtroi pyetje ministrit të Financave, Abdullah Hoti, lidhur me vlerësimin për mjedisin e kontrollit për mbikëqyrjen e brendshëm të financave publike, krahasimi i tyre për vitin 2014 dhe 2015.

Ministri Abdullah Hoti iu përgjigj deputetes Donika Kadaj-Bujupi

Deputeti Ismajl Kurteshi i parashtroi pyetje ministrit të Financave, Abdullah Hoti, lidhur me problemet e kontrollit të brendshëm për regjistrimin dhe menaxhimin e pasurisë, transaksioneve, të hyrave vetanake, prokurimit, ruajtjes dhe arkivimit të dokumentacionit nga ana e organizatave buxhetore.

Ministri Abdullah Hoti iu përgjigj deputetit Ismajl Kurteshi.

Deputetja Puhije Demaku i parashtroi pyetje ministrit të Punëve të jashtme, Enver Hoxhaj, lidhur me vendimin e Qeverisë së Norvegjisë që shqiptarëve të Kosovës, që kanë shtetësi norvegjeze, në pasaportat e tyre vendi i lindjes u shënohet “e panjohur”, edhe pse ata kanë adresë të vendit se në cilin qytet kanë lindur në Kosovë.

Ministri Enver Hoxhaj nuk ishte i pranishëm në sallë.

3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme

Kuvendi i miratoi pa vërejtje procesverbalet e seancave plenare, të mbajtura më 16 e 17 qershor 2016 dhe më 17 qershor 2016, në orën 17:00.

Kryetari i Komisioni Funkcional për Buxhet dhe Financa, Naser Osmani, propozoi që rendi i ditës i kësaj seance të plotësohet edhe me dy pika shtesë, duke vendosur për shmangie nga Rregullorja e Kuvendit për shqyrtimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016 dhe të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03. L-049 për financat dhe pushtetin lokal.

Pas deklarimit të kryetarëve të grupeve parlamentare, kryetari e hodhi në votim propozimin e lartshënuar për shqyrtimin e dy projektligjeve.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 64,
Kundër ----- 12,
Abstenime ----- 2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

I. Shqyrtimi dhe miratimi i Projektligjit nr. 05/L-109 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-071 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016 të bëhet me procedurë të përsheptuar - shmangie nga afatet procedurale, të parapara me nenin 56, paragrafi 1 dhe nenin 57, paragrafët, 3, 5,8dhe9 dhenenin64, paragrafi 4, të Rregullores e Kuvendit,si në vijim:

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016 të bëhet në seancën plenare më 7 korrik 2016.
2. Amendamentet eventuale për rishikimin e Buxhetit mund t'i adresohen Komisionit për Buxhet dhe Financa deri më 11 korrik 2016.
3. Komisionet e përhershme deri më 12 korrik 2016 duhet ta shqyrtojnë projektligjin dhe raportet me rekomandime t'ia paraqesin Komisionit për Buxhet dhe Financa.
4. Komisioni për Buxhet dhe Financa deri më13 korrik 2016 duhet ta paraqesë raportin me rekomandime për shqyrtim të dytë në seancë plenare.
5. Shqyrtimi i dytë Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016 të bëhet në seancën plenare,jo më vonë se më 14korrik 2016.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjithashtu, Kuvendi edhe për shqyrtimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-049 për financat e pushtetit lokal, mori këtë:

V E N D I M

I. Shqyrtimi dhe miratimi i Projektligjit nr. 05/L-108 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-049 për financat e pushtetit lokal bëhet me procedurë të përsheptuar - shmangie nga afatet procedurale të parapara menenin56, paragrafi 1, nenin 57, paragrafët, 3, 5,8dhe9 dhenenin64, paragrafi 4, të Rregullores e Kuvendit,si në vijim:

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-049 për financat e pushtetit lokal bëhet në seancën plenare më7 korrik 2016.
2. Komisionet e përhershme deri më 11 korrik 2016 duhet ta shqyrtojnë projektligjin dhe raportet me rekomandime t'ia paraqesin Komisionit për Buxhet dhe Financa.
3. Komisioni për Buxhet dhe Financa derimë13korrik 2016 duhet ta paraqesë raportin me rekomandime për shqyrtim të dytë në seancë plenare.

4. Shqyrtimi i dytë Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-049 për financat e pushtetit lokal 2016 bëhet në seancën plenare më 14 korrik 2016.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

* * *

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me pikat e rendit të ditës, si në vijim:

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-109 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-071 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim në parim.

Ai e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë së Kosovës që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe ta arsyetojë projektligjin.

Ministri i Financave, z. Abdullah Hoti, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi në hollësi Projektligjin nr. 05/L-109 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-071 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016.

Pastaj, kryetari hapi diskutimin për shqyrtimin e këtij projektligji në parim.

Lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-071 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016 diskutuan: Naser Osmani, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe të GP të LDK-së; Safete Hadërgjonaj, në emër të GP të PDK-së, Shqipe Pantina, në emër të GP të LVV dhe Fikrim Damka, në emër të GP “6+”, si dhe deputetët Xhevaire Izmaqu, Muhamet Mustafa, Besa Baftiu, Bekim Haxhiu, Fatmir Rexhepi, Albulena Haxhiu, Abdyl Ymeri, Vjosa Osmani, Rexhep Selimi, Emilija Rexhepi, Faton Topalli, Luljeta Gutaj-Veseli, Mytaher Haskuka, Hajdar Beqa, Danush Ademi, Ismajl Kurteshi, Naim Fetahu, Shukri Buja dhe Salih Salihu, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim miratimin në parim të këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për -----52,
Kundër ----- 2,
Abstenime ----- 8.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji nr. 05/L-109 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-071 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016.

2. Ngarkohen Komisioni FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa dhe komisionet e përhershme që në pajtim me vendimin e Kuvendit nr. 05-V-322 ta shqyrtojnë Projektligjin nr. 05/L-109

për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-071 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016 dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-049 për financat e pushtetit lokal

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim në parim.

Ai e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë së Kosovës që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe ta arsyetojë projektligjin.

Ministri i Financave, z. Abdullah Hoti, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi në hollësi Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-049 për financat e pushtetit lokal.

Pastaj, kryetari hapi diskutimin për shqyrtimin e këtij projektligji në parim.

Lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-049 për financat e pushtetit lokal diskutuan: Naser Osmani, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe të GP të LDK-së; Naim Fetahu, në emër të GP të PDK-së dhe Shqipe Pantina, në emër të GP të LVV, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim miratimin në parim të këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për -----51,
Kundër ----- 10,
Abstenime ----- 7.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji nr. 05/L-108 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal.

2. Ngarkohen Komisioni FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa dhe komisionet e përhershme që në pajtim me vendimin e Kuvendit nr. 05-V-323, ta shqyrtojnë Projektligjin nr. 05/L-108 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-100 për ndihmën shtetërore

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim në parim.

Ai e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë së Kosovës që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe ta arsyetojë projektligjin.

Ministri i Financave, z. Abdullah Hoti, para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi në hollësi Projektligjin për ndihmën shtetërore.

Pastaj, kryetari hapi diskutimin për shqyrtimin e këtij projektligji në parim.

Lidhur me Projektligjin për ndihmën shtetërore diskutuan: Naser Osmani, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe të GP të LDK-së; Shqipe Pantina, në emër të GP të LVV dhe deputeti Faton Topalli, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Ministri Abdullah Hoti dha sqarime në vërejtjet e deputetëve,

Pastaj, kryetari e hodhi në votim miratimin në parim të këtij projektligji.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për -----55,
Kundër -----3,
Abstenime ----- 9.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

1. Miratohet në parim Projektligji nr. 05/L-100 për ndihmën shtetërore.
2. Ngarkohen Komisioni Funksional për Buxhet dhe Financa dhe komisionet e përhershme që në pajtim me nenin 57 të Rregullores së Kuvendit, ta shqyrtojnë Projektligjin nr. 05/L-100 për ndihmën shtetërore dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-079 për investimet strategjike në Republikën e Kosovës

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni Funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti e Industri dhe Komisioni për Buxhet dhe Financa, në mbështetje të vendimit të seancës plenare nr. 05-V-303, datë9 qershor 2016, e kanë rishqyrtuar Projektligjin nr. 05/L-079 për Investimet strategjike në Republikën e Kosovës dhe Kuvendit ia kanë paraqitur raportin me rekomandime.

Kryetari i Komisionit Funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, z. Muhamet Mustafa, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin e komisionit.

Në këtë Projektligj ishin propozuar 35 amendamente.

Lidhur me amendamentet e propozuara diskutuan: Muhamet Mustafa, Fatmir Rexhepi, Shaip Muja, Ismet Beqiri, Besa Gaxheri, Bekim Haxhiu, Naser Osmani, Nait Hasani, Vjosa Osmani, Melihate Tërmkolli, Bardhyl Meta, kryeministri Isa Mustafa dhe ministrja Hykmete Bajrami, diskutimet e të cilëve janë dhënë transkript.

Kryetari i hodhi në votim një nga një amendamentet e propozuara, sipas radhës së paraqitur nga Komisioni Funksional.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34 dhe 35.

Pa këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votimi tekstin e projektligjit me amendamentet e miratuara.

* * *

Pas përsëritjes së votimit tri herë, kryetari konstatoi Kuvendi nuk ka kuorum për miratimin e Ligjit nr. 05/L-079 për investime strategjike në Republikën e Kosovës.

8. Emërimi i anëtarit të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës

Kryetari i njoftoi deputetët se Kryeprokurori i Shtetit, mbështetur në dispozitat e Ligjit për themelimin e Institutit Gjyqësor të Kosovës, Kuvendit të Republikës së Kosovës ia ka paraqitur propozimin për emërimin e anëtarit të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës.

Komisioni Funksional për Legjislacion e ka shqyrtuar propozimin e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për emërim.

Kryetarja e Komisioni Funksional për Legjislacion, Albulena Haxhiu, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin e komisionit.

Lidhur me emërimin e anëtarit të Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës diskutuan: Selville Halimi, në emër të GP të PDK-së; Armend Zemaj, në emër të GP të LDK-së; Albulena Haxhiu, në emër të GP të LVV dhe deputeti Mytaher Haskuka, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryetari e hodhi në votim propozimin e lartshënuar.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për -----59,
Kundër ----- 7,
Abstenime ----- 4.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Z. Haxhi Dërguti emërohet anëtar i Këshillit Drejtues të Institutit Gjyqësor të Kosovës, me mandat dy (2) vjeçar.

9. Zgjedhja e një (1) anëtari të Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni Funksional për Legjislacion, mbështetur në nenin 108, paragrafi 6, nënparagrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të nenit 5A të Ligjit nr. 05/L-033 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03 L -223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, ka zhvilluar procedurat për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtar të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Kuvendit ia ka rekomanduar zgjedhjen me votim të fshehtë të njërit nga dy kandidatët e propozuar.

Kryetarja e Komisioni FunkSIONAL për Legjislacion, Albulena Haxhiu, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin e komisionit.

Kryetari i sqaroi procedurat e votimit për zgjedhjen e një anëtarit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe kërkoi nga grupet parlamentare që ta propozojnë nga një anëtar në Komisionin votues, i cili do të administrojë me procedura e votimit të fshehtë për zgjedhjen e një anëtarit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Me propozimin e grupeve parlamentare, Kuvendi e formoi Komisionin votues në këtë përbërje. Emilija Rexhepi nga GP i PDK-së, Besa Gaxherri nga GP i LDK-së, Mytaher Haskuka nga GP i LVV, Nenad Rashiq nga GP LS dhe Qerim Bajrami nga GP “6+”.

Pastaj, kryetari i ftoi deputetët një nga një që të votojnë.

Par përfundimit të votimit dhe numërimit të votimit të fshehtë, në emër të Komisionit votues, raportin e rezultateve të votimit e paraqiti deputetja Emilija Rexhepi, si vijon:

Në votim kanë marrë pjesë 77 deputetë. Të pavlefshme ishin 31 fletëvotime. Kandidati Nenad Laziq i ka fituar 42 vota, ndërsa kandidati Bogolub Staletoviq i ka fituar 4 vota. Në bazë të këtij rezultati duhet të shkohet në rrethin e dytë të votimit.

Kryetari në rrethin e dytë të votimit i ftoi një nga një deputetët për votim të fshehtë.

Par përfundimit të votimit të rrethi të dytë të votimit fshehtë dhe numërimit të fletëvotimeve, në emër të Komisionit votues, raportin e rezultateve të votimit e paraqiti deputetja Emilija Rexhepi, si vijon:

Në votim kanë marrë pjesë 61 deputetë. Të pavlefshme ishin 20 fletëvotime. Kandidati Nenad Laziq i ka fituar 38 vota, ndërsa kandidati Bogolub Staletoviq i ka fituar 3 vota.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Z. Nenad Laziq zgjidhet anëtar i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, nga radha e komunitetit serb, me mandat pesë (5) vjeçar.

10. Zgjedhja e zëvendës drejtorit të Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit

Kryetari i njoftoi deputetët se Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, mbështetur në Ligjin për rregullimin e shërbimeve të ujit, i ka zhvilluar procedurat për përzgjedhjen e kandidatit për zëvendës drejtor të Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit dhe Kuvendit ia ka rekomanduar zgjedhjen me votim të fshehtë të njërit nga dy kandidatët e propozuar.

Kryetarja e Komisionit FunkSIONAL për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, znj. Duda Balje, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin e komisionit.

Me propozim të kryetarit, Kuvendi e autorizoi Komisioni votues me përbërje nga pika e mëparshme që t'i zhvillojë procedurat e votimit edhe për këtë pikë.

Pas zhvillimit të procedurave të votimit të fshehët dhe numërimit të votave, në emër të Komisionit votues raportin e rezultateve të votimit e paraqiti deputetja Besa Gaxheri.

Në votim kanë marrë pjesë 77 deputetë. Të pavlefshme ishin 15 fletëvotime.

Kandidati Halil Bllaca i ka fituar 30 vota, ndërsa kandidati Alush Rama i ka fituar 32 vota.

Kryetari konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

Kandidatët e propozuar, z. Halil Bllaca dhe z. Alush Rama, asnjëri nuk i morivotat e nevojshme të Kuvendit për t'u zgjedhur zëvendës drejtor i Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit.

11. Shqyrtimi i raportit të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2015

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni Funkcional për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media e ka shqyrtuar raportin vjetor të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2015 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Gjithashtu, edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor financiar të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2015 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Raportin e Komisionit Funkcional për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media e paraqiti dhe e arsyetoi deputetja Xhevahire Izmaku.

Lidhur me raportin e Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2015 diskutuan: Xhevahire Izmaku, në emër të GP të PDK-së; Alma Lama, në emër të GP të LDK-së dhe Shqipe Pantina, në emër të GP të LVV, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryetari e hodhi në votim raportin vjetor të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2015.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për -----32,
Kundër -----13,
Abstenime ----- 7.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi nuk ka kuorum për miratimin e raportit vjetor të Radiotelevizionit të Kosovës për vitin 2015.

12. Shqyrtimi i raportit të Zyrës së Rregullatorit për Energji për vitin 2015

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar raportin vjetor të Zyrës së Rregullatorit për Energji për vitin 2015 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Edhe Komisioni për Buxhet e Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor të Zyrës së Rregullatorit për Energji për vitin 2015 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Kryetari i Komisionit FunkSIONAL, Muhamet Mustafa, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin e komisionit.

Lidhur me raportin vjetor të Zyrës së Rregullatorit për Energji për vitin 2015 diskutuan: Sala Berisha-Shala, në emër të GP të PDK-së, Donika Kadaj-Bujupi, në emër të GP të LVV, si dhe deputetët Abdyl Ymeri, Shaip Muja, Muhamet Mustafa, Visar Ymeri dhe Albulena Haxhiu, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesuesi e hodhi në votim raportin vjetor të Zyrës së Rregullatorit për Energji për vitin 2015.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për -----30,
Kundër -----21,
Abstenime -----20.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi nuk e miratoi raportin vjetor të Zyrës së Rregullatorit për Energji për vitin 2015.

13. Shqyrtimi i raportit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2015

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni FunkSIONAL për Legjislacion e ka shqyrtuar raportin vjetor të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2015 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar që ta miratojë. Gjithashtu, edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar këtë raport dhe ia ka rekomanduar për miratim Kuvendit.

Kryetarja e Komisionit FunkSIONAL, Albulena Haxhiu, e paraqiti dhe arsyetoi raportin e komisionit.

Raportin e Komisioni për Buxhet dhe Financa e paraqiti dhe arsyetoi raportin deputetja Safete Hadërgjonaj.

Lidhur me raportin vjetor të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2015 diskutuan: Selvije Halimi, në emër të GP të PDK-së, Agim Ademi, në emër të GP të LDK-së, Albulena Haxhiu, në emër të GP të LVV, si dhe deputetët Ismajl Kurteshi dhe Driton Çausi, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesuesi e hodhi në votim raportin vjetor të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2015.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për -----53,
Kundër -----6,
Abstenime -----6.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi raportin vjetor të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për vitin 2015.

14. Shqyrtimi i propozimit për shpalljen e 5 Shtatorit - “Ditë të Bamirësisë Nëna Terezë”

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 4 korrik 2016, ka vendosur që Kuvendit të Republikës së Kosovës t’ia paraqesë propozimin që data 5 shtator të shpallet “Ditë e Bamirësisë Nëna Terezë” në Republikën e Kosovës.

Lidhur me propozimin e Kryesisë së Kuvendit që data 5 shtator të shpallet “Ditë e Bamirësisë Nëna Terezë” në Republikën e Kosovës, diskutuan: Adem Grabovci, në emër të GP të PDK-së; Salih Morina, në emër të GP të LDK-së; Puhije Demaku, në emër të GP të LVV, si dhe deputetët Melihate Tërmkolli, Alma Lama, Xhevahire Izmaqu, Blerta Deliu-Kodra, Adem Salihaj dhe Mexhide Mjaku-Topalli, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Në fund, kryesuesi e hodhi në propozimin e Kryesisë së Kuvendit që data 5 shtator të shpallet “Ditë e Bamirësisë Nëna Terezë” në Republikën e Kosovës.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për -----61,
Kundër -----0,
Abstenime -----0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi mori këtë:

V E N D I M

I. 5 Shtatori shpallet “Ditë e Bamirësisë Nëna Terezë” në Republikën e Kosovës.

II. Vendimi publikohet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Kryesuesi i mbylli punimet e seancës plenare më 11 korrik 2016, në orën 12:55 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale